

Case Study Summary: Gjirokaster
G. Dipaola
19.12.1995
Draft

Analizat e tipareve lokale te lidhur me tregun e tokes:
Gjirokaster

4.1 Ne rrethin e Gjirokastres tokat jane punuar ne masen 60% Ne nje shikim te pare, ato te minoritetit grek, ne fushen e Dropullit, duken krejt te "abandonuara", nese perdor te njejten fjale qe perdoren vete fshataret. Minoriteti grek eshte mbajtur ne pergjithesi si me i favorizuari persa i perket marrjes se vizave per te emigruar ne Greqi. Ne konsullate brez te favorizuar ku futen minoranca greke dhe besimi orthodox. Ne mbremje, duke kaluar ne rrugen permes fushave, fshatrat e minoritetit grek perzihen ne nate me fagen e vargut te kodrave gurore ku ata jane vendosur: vetem pak shtepi kane drite, te tjerat jane bosh. Ne mengjes arat poshte fshatrave duken edhe me te shkretuara, si ka mundesi, sepse eshte e nje cilesie te mire dhe e pa punuar. Disa fshatra jane krejtesisht te zbrazur, dhe banohen nga pleg qe femijet dhe niperit i kane ne Greqi.

Per me teper, pozicioni strategjik pergjate rruges kryesore qe te con ne Greqi, e rrahur vazhdimisht nga cdo shqiptar, afersia e madhe me qytetin e Gjirokastres, qe eshte qendra e rrethit, prania e ujit mbi- dhe nen-toke, i bejne fshatrave te fushes se Dropullit nje vend te privilegjuar per prodhime bujqesore te cilesise se larte. Ne kohen e koperatives, prodhimi shkante per grurin 60-70 kv/ha, per misrin 80-90 kv/ha, vreshta dhe drure frutore, pervec perimeve. Foragjeret mbilleshin e korreshin 5-6 here ne vit. E per me teper modeli mbizoterues i perdorimit te tokes, kur nuk eshte e braktisur, eshte mbjellja e pak gruri per perdorim shtepiak, pak miser dhe jonxhe, kryesisht per lopen e vetme te shtepise, se ciles i shtohenedhe 10-15 dele mesatarisht. Mu krijua pershtypja qe familjet perdorin token ne minimumin e mundesise qe ofron ajo, duke mbizoteruar nje regjim i plotesimit te nevojave te konsumit shtepiak: mish, qumesht dhe produktet e tyre.

Me gjithë zgjidhjen e lehtesuar te emigrimit me synim kryesor drejt Greqise te femijeve te tyre, permiresimin e mireqenies dhe te modelit te jetes, asnje nuk shet tokat e tyre, asnje nuk ka nder mend te shese, shume pak e japin me qira. Pra, ne fushen e Dropullit, nder minoritetin grek, zgjedhjet strategjike te familjeve duket sikur ndjekin modelin e investimit maksimal per emigracionin ne Greqi dhe regjimin minimal te perdorimit te tokes, pa arritur ne shitblerjen e pasurise, pra te shitjes dhe blerjes.

4.2 I njejti model mund te verehet me pak, larg ne fshatrat

shqiptare te anes tjeter te fushes, te vendosur ne faqet e maleve lindore. Suha e Stegopuli nga rruga kryesore jane ndare nga lumi, mbi te cilin kalojne pak ura, dhe nga kushtet e veshtira te rrugeve qe kane ngalur qe nga koha kur perdoreshin per transport. Cilesia e tokes ketu eshte e ndryshme: pervec nje fushe te vogel, me e ngritur ne krahasim me ate te Dropullit, terrenet bujqesore jane gurore, te pjerret, te shperndare ne rrudhat e fageve te malit, te pa ujitura. Ne terrenin e fushes ekzistonte, para mbylljes se kooperatives, nje sistem ujitje qe siguronte pjellori te larte. Keto toka sot jane te fshatit Suhe, ish qendra e kooperatives. Ketu bente pjese edhe Stegopuli, 2 km larg Suhes me rrugen e hapur. As ne Suhe as ne Stegopul nuk shkojne autobuse, vetem jane pak makina qe qarkullojne dhe kush do te shkoje ne Gjirokaster duhet te shkoje ne kembe deri ne rrugen qe vjen nga Labova - 3 km nga Suha dhe 5 km nga Stegopuli- dhe te presesh nje autobus. Ne pergjithesi jane dy ne dite. Midis Suhes dhe Stegopulit ndodhet nje fushe e vogel dikur e ujitur; persa i perket afersise, Stegopuli eshte me larg se Suha.

Megjithate, ka rendesi midis faktoreve te tjere, qe midis Suhes dhe Stegopulit banon nje pjese e minoritetit Vllah, por me nje perpjestim krejt te kundert: ne Stegopul 80% eshte Vllah dhe pjesa tjeter shqiptare vendas, ndersa ne Suhe, Vllahet jane 20%. Vllahet jane popullsi me origjine nga cobanet endacake, qe praktikonin levizjen nga fushat e larta te Shqiperise juglindore deri ne kodrat e bregdetit te Sarandes. Prejardhja e grupeve sot ne Shqiperi eshte nga Rumania dhe Greqia; keta ketu jane me origjine greke. U vendosen ketu qe me 1957-1958, te detyruar nga regjimi te hyjne ne kooperative. Kooperativa e Suhes u formua pikerisht me 1958. U konfiskuan tufat dhe u perqendruan ne te dy fshatrat. Transformimi i tyre i detyruar ne popullsi te palevizshme beri qe te nderthuren me fshatrat ekzistues. Iu dhane shtepi ekzistuese, qe iu moren vendasve te cilet kishin me shume se nje, si dhe trualle qe ishin brenda vijes se verdhe te fshatit. Keto trualle ishin ose te lire, qe i kishte kooperativa, ose te vendasve qe i kishin para 1958.

4.3 Ne Suhe shperndarja e tokes ishte pagesore sipas ligjit: u llogarit sasia per fryme dhe vendosja me short. Pakica Vllahet nuk u diskriminua. Cdo familjeje i ra nje pasuri e mjaftueshme: per cdo pjesetar te familjes nga 3,5 dynym. Tokat e fshatit te ndara kane qene ato te fushes se meposhtme dhe ato gurore te siperme, te perdorura si kullota ose per kultivim jonxhe. Shumica e familjeve u kenaq nga ndarja e tokes dhe nuk kishte konflikte me ish pronaret qe ankohen per token bujqesore-nderkohe qe ka ankesa per ish pronen per shortin brenda vijes se verdhe (ish pronaret i kap ligji i kompesimit te 1995). Ne Suhe nuk ka konflikte te pronesise se para vitit 1946-viti kur u be reforma e pare agrare shqiptare-pjesa me e madhe e vendasve te fshatit nuk ishin pronare, por merrnin toke me qira nga nje familje gjirokastrite, pronare te medhenj te zones dhe pronare te nje cifliku. Sistemi i dhenies me qira fiksonte dhenien e 1/3 se korrjeve dhe keto shkonin per pak

familje. Vec kesaj pak familje vendase ne Suhe kishin shume pak dynym, ne pergjithesi me pak se moren nga reforma e 1991.

Ne Stegopuli situata eshte krejt e kundert, megjithe afersine gjeografike. Para 1946, tokat e Stegopulit zoteroheshin nga te njejtet vendas shqiptare qe sot duan te marrin pjese te tyre. Por Vllahet nuk lejojne shkeljen e ligjit-qe i jep mundesi shperndarjes per fryme me short-dhe kane ndare token e fshatit sipas ligjit te dyte, pra sipas perberjes familjare. Shumica e popullsisë Vllahe kishte shumicen edhe ne Komisionin e Fshatit. Rezultati ishte konflikti mes pakices vendase dhe shumices se ardhur Vllahe. Sot, konflikti nuk eshte zbutur por perkundrazi ka tension te rritur. S'eshte arritur nje kompromis, as kur vendasit propozuan te marrin per fryme toke ne parcelat e ish prones, sipas ligjit. Vllahet nuk besojne se kerkesat e tyre do ndalojne me kaq, por kane frike se duke pasur nje pjese te ish prones ka rrezik per te kerkuar ne te ardhmen pjesen tjeter te prones. Ndaj vendasit nuk moren pjese ne shperndarje, duke kundërshtuar kete vleresim. Moren ne perdorim parcelat e caktuara, ne pergjithesi nje te pesten e fshatit, pa firmosur tapine.

Nga konflikti i pa zgjidhur vjen nje ndjenje e forte pasigurie per pronen. Vendasit presin ndryshimin e ligjit, qe qeveria te plotesoje kerkesat e tyre, qe zgjedhjet te sjellin nje zgjedhje te permiresuar. Vllahet kane toke por ndihen pa "baze", pa pasuri te sigurt qe te mbeshteten. Jane te sigurte qe copat brenda fshatit do merren nga ish pronaret, te pakten ato qe jane akoma te lira. Ata qe tani kane shtepite e tyre dhe toke nga reforma e '91 jane te vendosur ta mbrojne me cdo kusht, edhe me pushke. Behet fjale, ne fund te fundit, per nje te drejte te qendrojne ne fshat me te drejtat e vendasit: me bilancin e 40 vjeteve te historise se kooperatives dhe socializmit ne fshat, Vllahet ndiejne se kane dhene ose marre, per te perdorur zhargonin lokal, po aq sa vendasit. Vendasve iu jane marre toka, Vllaheve bagetia (per familje arrijne ne 500-600 koke).

Midis Vllaheve dhe vendasve, nderkaq, nuk ka diferenca prodhimi. Blektoria eshte aktiviteti i vetem qe duket se ka pak prodhim, ndersa bujqesia ngelet e kufizuar-edhe ne nje te neserme me infrastrukture me te mire-me konsum shtepiak. Edhe ketu modeli i prodhimit eshte pak grure per konsum shtepiak, miser dhe jonxhe per kafshet: ka model maksimal te investimit per emigracionin dhe regjim minimal per perdorimin e tokes.

4.4 Zgjedhja e emigracionit ne Greqi eshte edhe ketu nje perberes i rendesishem i strategjise ekonomike te familjeve, me i paket ne krahasim me fshatrat e fushes se minoritetit te gjuhes greke. Ikja nga fshati ketu, ne Suhe e Stegopul eshte me pak e dukshme dhe percaktuese. Njerezit ikin ne Greqi pak dhe per pak kohe, kthehen. Vllahet favorizohen ne krahasim me vendasit, por nuk kane gjuhen greke dhe prandaj jane me pak ne krahasim me banoret e fushes.

As ketu nuk shitet toke, dhe s'ka sinjale te nje tregu te ardhshem. Per me teper nuk binden te kultivojne per treg, as per rritjen e kafsheve, familjet nuk tjetersojne perdorimin dhe pasurine e tokes, duke u mbajtur ne paketen e alternativave te strategjise ekonomike te shtepise, si ne fshatrat e fushes se Dropullit. Por llogjika ku mbeshteten zgjedhjet e familjeve jane krejt te ndryshme ne nje rast, fusha pjellore eshte e gjuhes greke, ne anen tjeter, fshatrat e kodres dhe te malit, duket sikur po pershtaten me situaten duke u mbeshtetur ne kushtet e tregut dhe prodhime shume te thjeshte.

Ne rastin e familjeve te fushes se Dropullit, te pakices greke, toka ka cilesi te mire dhe rezultatet e kultivimit ne ish kooperative jane nje kujtim i gjalle. Sot nuk vlen te kultivosh nga cmimet e larta per prodhimin, mekanizimin, plehrat kimike, per infrastrukturen ujtese qe mungon dhe ul dukshem prodhimin; ne fund te fundit per cmimet e tregut, shume te ulet ne krahasim me koston e prodhimit dhe corganizimi i sistemit te tregut vete ne krahasim me sistemin e shperndarjes dhe ate te prodhimit. Per nje pjese tjeter, zgjedhja e emigracionit eshte relativisht e pranueshme dhe familjet "investojne" njerezit e moshes prodhuese ne Greqi, ku prodhojne burime ekonomike per pjesen e familjes qe ngel ne fshat (grate dhe pleqte). Por zgjedhja e emigracionit nuk eshte percaktuese, te pakten per qellimet. Prespektiva e emigracionit eshte e perkohshme ne pritje te krijimit te rasteve te punes ne Shqiperi. Ne kete moment burimi toke do behet i rendesishem dhe i frytshem. Toka ketu nuk shitet sepse eshte pasuri dhe burim i vlefshem pervec mundesive aktuale te tjera (emigracioni), aktiv ne momentin perkates. Per tani eshte ne stand by; nuk shitet. Familjet presin permiresimin e situates: nga drejtimi qe do marre, do vendosin cfare te bejne. Por kane karta te ndryshme ne dore.

4.5 E ndryshme eshte llogjika e kodrave dhe maleve pak km me larg, pertej lumit. As ketu nuk binden sot per sot te kultivojne token me kultura per treg: grure, jonxhe, ne rastin e Suhes. Ose te rrisin tufa te medha per shitjen e qumeshtit dhe te krereve, si ne rastin e Stegopulit. Edhe ketu koston, kushtet e prodhimit, cmimet e pranimi ne treg jane faktore kufizues. Me keq nga afersia gjeografike qe i shtohet koston se transportit dhe "largesia" nga tregu, jo vetem fizike: familjet qe ballafaqohen me tregun per pak krere me shpesh shesin nen cmim, per te sjelle ne shtepi nje fitim pasi perballojne nje udhetim, ose sepse shitesi me kamion qe vjen per te blere kontrollon sheshin dhe nuk e di kur do kthehet.

I ndryshem eshte ne fakt pranimi i burimeve nga emigracioni. Per vendasit eshte me e veshtire te emigrojne sesa shqiptaret e tjere te rrethit te Gjirokastres. Per Vllahet eshte me e lehte te marrin vize, por relativisht, dhe jo sa merr minoriteti grek. Njerezit kthehen me shpesh dhe familjet nuk mund te mbeshteten mbi burimet e emigracionit si burime te vazhdueshme, ose pak te parashikueshme. Toka nderkaq nuk behet alternative, por nje

komponent fizik nga i cili nuk hiqet dore, ne paketen e strategjive ekonomike shtepiake. Pa toke nuk ke shume per te bere sot. S'jetojne ndryshe, s'kane burime te sigurta, ose mbi te cilet mund te mbeshtetesh. Keshtu toka nuk shitet, nuk jepet me qira, sepse perben bazen mbi te cilen ngrihet mireqenia e familjes-ose mund te ngrihet kur kushtet e prodhimit dhe te tregut do jene me te favoreshme.

Diferenca midis cilesise se burimit toke dhe pozicioni gjeografik eshte ne besueshmerine e burimeve te emigracionit. Kombinimi i dy faktoreve sjell llogjike te ndryshme ne strategjite ekonomike te familjeve, megjithese efektet finale jane te njejte: ndalimi i tregut te tokes dhe prodhimit te pak gruri dhe perimeve per konsum shtepiak, miser dhe jonxhe per lopet dhe delet. Ne rastin e Stegopulit, ndihet shume pasiguria subjektive qe vjen nga konfliktet e pazgjidhurdhe nga llogjika e kunderte te ardhurve (Vllah) dhe e vendasve.

Ne rastin e Suhes, pasiguria formale e prones-nuk kane marre akoma tapite, duket se s'do kete konflikte- paraqitet si pengese per shitjen e tokes, qe si rezultat nuk merret ne konsiderate me pas. Si ne njerin dhe ne tjetrin rast, shitja duket e mundshme ne perputhje me largesine perfundimtare ose gati perfundimtare nga fshati. Kjo ndodh me procecin e urbanizimit (ata qe ikin ne qytet dhe nuk lene prinderit ne fshat), ose per emigracionin (edhe ne kete rast prinderit nuk jane me ne fshat).

Por nese shitja duket e mundshme kur siguron ne dore nje dokument pronesie dhe kur femijet shkeputen nga fshati, rasti i fushes se Dropullit vlen per te treguar nje faktor tjetër te rendesishem qe paralizon fuqine e tregut te tokes : pasiguria per zhvillimet e ardhshme social- ekonomike (do te merakosen te vijne apo jo ? do gjejne nje pune ne Shqiperi apo jo ?), e veshtiresuar nga pasiguria qe vjen nga bota politike. Ky faktor i fundit eshte sot gjithnje prezent midis faktoreve qe perbejne pasigurine subjektive per pasurine.